



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1887/ 3 prot.,

Datë: 02.08.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Colombo” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-72219-06-12-2023, me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Ramiz Aranitasi” Çorovodë” me fond limit 41,247,773.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13-06-2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Skrapar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Colombo” SHPK.
Lagjia “Kryengritja e Fierit”, rruga Vangjel Rrushku,
godina nr. 67, Fier

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Skrapar
ARKITEKT KASËMI, nr.1, 5401, Çorovodë, SKRAPAR

Në datën 01.08.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1887 protokoll dhe nr. ankimi elektronik A/2023/3332 e operatorit ekonomik “Colombo” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-72219-06-12-2023 me objekt ‘Rikonstruksion i shkollës “Ramiz Aranitasi” Çorovodë” me fond limit: 41,247,773.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13-06-2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Skrapar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Colombo” SHPK.

Bazuar në gjurmën “b”, të pikës 4, të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Colombo” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1887/2023 prot., datë 01.08.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik “COLOMBO”, s’kualifikohet për arsyet si më poshtë: Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit , pikën 2.2.3 , të DST-ve. Operatori ekonomik, nuk ka deklaruar në (shtojçën 8) Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, shlyerjen e detyrimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, për të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin e tij sipas të dhënave të QKB-se, në sistem ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore , për vitin 2022.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 02.08.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

Anëtar
Anila Malaj